

God's Favourite

By Elder Karl D. Hirst
Of the Seventy

Fëmija i Parapëlqyer i Perëndisë

Nga Plaku Karl D. Hirst,
i Të Shtatëdhjetëve

October 2024 general conference

Being filled with God's love shields us in life's storms but also makes the happy moments happier.

Before I begin, I should tell you that two of my children have passed out whilst speaking at pulpits, and I have never felt more connected to them than in this moment. I've got more on my mind than just the trapdoor.

Our family has six children, who sometimes tease one another that they are the favourite child. Each has different reasons for being preferred. Our love for each of our children is pure and fulfilling and complete. We could not love any one of them any more than another—with each child's birth came the most beautiful expansion of our love. I most relate to my Heavenly Father's love for me through the love that I feel for my children.

As they each rehearse their claims to be the most loved child, you might have thought that our family had never had an untidy bedroom. The sense of blemishes in the relationship between parent and child is diminished with a focus on love.

At some point, perhaps because I can see that we are heading toward an inevitable family riot, I'll say something like, "OK, you have worn me down, but I am not going to announce it; you know which one of you is my favourite." My goal is that each one of the six feels victorious and all-out war is avoided—at least until next time!

In his Gospel, John describes himself as "the disciple whom Jesus loved," as if that arrangement were somehow unique. I like to think that this

Të qenit i mbushur me dashurinë e Perëndisë na mbron në stuhitë e jetës, por gjithashtu i bën çastet e lumtura edhe më të lumtura.

Përpara se të filloj, duhet t'ju them se dy prej fëmijëve të mi u kanë rënë të fikët ndërsa flisnin në foltore dhe nuk jam ndier kurrë më i lidhur me ta sesa në këtë çast. Kam më shumë në mendje sesa thjesht kapaxhën e kokës.

Familja jonë ka gjashtë fëmijë, që ndonjëherë e ngacmojnë njëri-tjetrin duke pretenduar se janë fëmija i parapëlqyer. Secili ka arsye të ndryshme pse është i parapëlqyeri. Dashuria jonë për secilin prej fëmijëve tanë është e pastër, përbushëse dhe e plotë. Nuk ka se si ta duam njërin më shumë se tjetrin, me lindjen e secilit fëmijë erdhi zgjerimi më i bukur i dashurisë sonë. Më së shumti e kuptoj dashurinë e Atit tim Qiellor për mua nëpërmjet dashurisë që ndiej për fëmijët e mi.

Ndërsa secili prej tyre ngre pretendimin e vet se është fëmija që e duan më shumë, mund të mendoni se në familjen tonë nuk ka pasur ndonjëherë një dhomë gjumi të parregullt. Ndjenja e të metave në marrëdhëniet midis prindit dhe fëmijës zvogëlohet kur ke në fokus dashurinë.

Në njëfarë pike, ndoshta ngaqë mund të shoh se po futemi në një trazire të pashmangshme familjare, them diçka të tillë: "Mirë, më lodhët, por nuk do t'jua them; ju e dini se cili prej jush është i parapëlqyer im". Synimi im është që secili prej të gjashtë fëmijëve të ndihet fitimtar dhe të shmanget lufta e gjithanshme – të paktën deri herën tjetër!

Në Ungjillin e tij, Gjoni e përshkruan veten si "dishepulli, të cilin Jezusi e donte", sikur ajo deklaratë të qe në njëfarë mënyre diçka unike.

was because John felt so completely loved by Jesus. Nephi gave me a similar sense when he wrote, “I glory in my Jesus.” Of course, the Saviour isn’t Nephi’s any more than He is John’s, and yet the personal nature of Nephi’s relationship with “his” Jesus led him to that tender description.

Isn’t it wonderful that there are times when we can feel so fully and personally noticed and loved? Nephi can call Him “his” Jesus, and so can we. Our Saviour’s love is the “highest, noblest, strongest kind of love,” and He provides until we are “filled.” Divine love never runs dry, and we are each a cherished favourite. God’s love is where, as circles on a Venn diagram, we all overlap. Whichever parts of us seem different, His love is where we find togetherness.

Is it any surprise that the greatest commandments are to love God and to love those around us? When I see people showing Christlike love for one another, it feels to me as if that love contains more than just their love; it is love that also has divinity in it. When we love one another in this way, as completely and fully as we can, heaven gets involved too.

So if someone we care about seems distant from a sense of divine love, we can follow this pattern—by doing things that bring us closer to God ourselves and then doing things that bring us closer to them—an unspoken beckoning to come to Christ.

I wish I could sit down with you and ask you what circumstances cause you to feel God’s love. Which verses of scripture, which particular acts of service? Where would you be? What music? In whose company? General conference is a rich place to learn about connecting with heaven’s love.

But perhaps you feel a long way from the love of God. Maybe there is a chorus of voices of discouragement and darkness that weighs into your thoughts, messages telling you that you are too wounded and confused, too weak and over-

Më pëlqen të mendoj se kjo erdhi ngaqë Gjoni ndiente dashuri tejet të plotë nga Jezusi. Nefi më dha një ndjesi të ngjashme kur shkroi: “Unë ngazëllehem në Jezusintim”. Natyrisht, Shpëtimtari po aq sa është i Nefit, është edhe i Gjosit dhe megjithatë natyra vetjake e marrëdhënies së Nefit me Jezusin “e tij” e çoi në atë përshkrim të dashur.

A nuk është e mrekullueshme që ka raste kur mund të ndiejmë që na vënë re dhe na duan kaq plotësisht dhe kaq personalisht? Nefi mund ta quajë Atë Jezusin “e tij”, po ashtu edhe ne. Dashuria e Shpëtimtarit tonë është “lloji më i lartë, më fisnik, më i fuqishëm i dashurisë” dhe Ai na e jep atë derisa të “ngop[emi]/mbushe[mi]”. Dashuria hyjnore nuk shteron kurrë dhe secili prej nesh është një bir ose bijë e Tij e dashur dhe e parapëlqyer. Dashuria e Perëndisë është ashtu si [pjesa e përbashkët e mbivendosjes së] rrathëve në diagramin e Venit, është ajo që na bashkon. Cilatdo qofshin ato pjesë tonat që duken të ndryshme, dashuria e Tij është vendi ku gjejmë bashkimin.

A është ndonjë çudi që urdhërimet më të mëdha janë të duam Perëndinë dhe të duam njerëzit rreth nesh? Kur shoh njerëz që tregojnë dashuri si të Krishtit për njëri-tjetrin, ndiej sikur ajo dashuri përmban më shumë sesa thjesht dashurinë tyre; është dashuri që ka edhe natyrë hyjnore brenda saj. Kur e duam njëri-tjetrin në këtë mënyrë, sa më tërësisht dhe plotësisht që mundemi, aty përfshihet edhe qielli.

Pra, nëse dikush që e kemi për zemër, duket i larguar nga një ndjesi e dashurisë hyjnore, ne mund të ndjekim këtë model: të bëjmë gjëra që na afrojnë më pranë Perëndisë vetë ne dhe më pas të bëjmë gjëra që na afrojnë më pranë tij/saj – një thirrje kjo e pashprehur për të ardhur te Krishti.

Do të doja të mund të ulesha me ju dhe t’ju pyesja se cilat rrethana ju bëjnë ta ndieni dashurinë e Perëndisë. Cilat vargje të shkrimit të shenjtë, cilat vepra specifike shërbimi? Ku do të ishit? Çfarë muzike? Në shoqërinë e kujt? Konferenca e përgjithshme është një vend plot me mundësi për të mësuar rreth lidhjes me dashurinë e qiellit.

Por mbase ndiheni larg nga dashuria e Perëndisë. Ndoshta ka një kor zërash shkurajimi dhe errësire që ju rëndon mendimet, mesazhe që ju thonë se jeni tepër i/e lënduar dhe i/e pështjelluar, tepër i/e dobët dhe i/e shpërfillur, tepër i/e

looked, too different or disoriented to warrant heavenly love in any real way. If you hear those ideas, then please hear this: those voices are just wrong. We can confidently disregard brokenness in any way disqualifying us from heavenly love—every time we sing the hymn that reminds us that our beloved and flawless Saviour chose to be “bruised, broken, [and] torn for us,” every time we take broken bread. Surely Jesus removes all shame from the broken. Through His brokenness, He became perfect, and He can make us perfect in spite of our brokenness. Broken, lonely, torn, and bruised He was—and we may feel we are—but separated from the love of God we are not. “Broken people, perfect love,” as the song goes.

You might know something secret about yourself that makes you feel unlovable. However right you might be about what you know about yourself, you are wrong to think that you have put yourself beyond the reach of God’s love. We are sometimes cruel and impatient toward ourselves in ways that we could never imagine being toward anyone else. There is much for us to do in this life, but self-loathing and shameful self-condemnation are not on that list. However misshapen we might feel we are, His arms are not shortened. No. They are always long enough to “[reach our] reaching” and embrace each one of us.

When we don’t feel the warmth of divine love, it hasn’t gone away. God’s own words are that “the mountains shall depart, and the hills be removed; but [His] kindness shall not depart from [us].” So, just to be clear, the idea that God has stopped loving should be so far down the list of possible explanations in life that we don’t get to it until after the mountains have left and the hills are gone!

I really enjoy this symbolism of mountains being evidence of the certainty of God’s love. That powerful symbolism weaves into accounts of those who go to the mountains to receive revelation and Isaiah’s description of “the mountain of the Lord’s house” being “established in the top of the mountains.” The house of the Lord is the home of our most precious covenants and a place for us all to retreat and sink deeply into the

ndryshëm/me ose i/e çorientuar për ta garantuar dashurinë qiellore në çfarëdo mënyre reale. Nëse i dëgjoni ato ide, atëherë, ju lutem, mbajeni vesh këtë: ata zëra thjesht e kanë gabim. Ne mund ta shpërfillim bindshëm copëtimin e brendshëm të çfarëdo lloji [si diçka] që na shkualifikon për dashurinë qiellore, sa herë që këndojmë himnin që na kujton se Shpëtimtari ynë i dashur dhe i patëmetë zgjodhi të “vr[itej dhe] cop[t]ohej” për ne”, sa herë që marrim bukën e copëtuar. Pa dyshim, Jezusi e heq të gjithë turpin nga personat e copëtuar së brendshmi. Nëpërmjet copëtimit të Tij, Ai u bë i përsosur dhe mund të na bëjë të përsosur edhe ne pavarësisht nga copëtimi ynë i brendshëm. Të copëtuar, të vetmuar, të rrahur dhe të mavijosur si Ai, mund ta ndiejmë se jemi edhe ne, por të ndarë nga dashuria e Perëndisë, nuk jemi. “Me dashuri [t’përsosur], për njerëz t’thyer”, siç e thotë dhe kënga.

Ju mund të dini diçka të fshehtë për veten tuaj që ju bën të ndiheni se nuk mund t’ju duan. Sado të drejtë të keni për atë që dini për veten, gaboheni nëse mendoni se keni shkuar përtej shtrirjes së dashurisë së Perëndisë. Ndonjëherë jemi mizorë e të padurueshëm me veten në mënyra që nuk mund ta imagjinonim kurrë se do të ishim ndaj dikujt tjetër. Ka shumë për të bërë në këtë jetë nga ana jonë, por neveria ndaj vetvetes dhe vetëdënimi i turpshëm nuk janë në atë listë. Sado të shformuar që mund të ndiejmë senejemi, krahët e Tij nuk janë shkurtuar. Jo. Ata janë gjithnjë mjaftueshëm të gjatë që “pran’ [na] afrohe[n]” dhe e përqafojnë secilin prej nesh.

Kur nuk e ndiejmë ngrohtësinë e dashurisë hyjnore, nuk është se ajo është larguar. Perëndia e thotë me fjalët e veta se “edhe sikur malet të zhvendoseshin dhe kodrat të luanin nga vendi, dashuria [e Tij] nuk do të largohet prej [nesh]”. Pra, thjesht për të qenë të qartë, ideja se Perëndia nuk na do më, duhet të jetë aq poshtë në listën e shpjegimeve të mundshme në jetë, sa që nuk do ta arrijmë dot derisa malet të jenë larguar dhe kodrat të jenë zhdukur!

Më pëlqen shumë kjo simbolikë e maleve si provë e realitetit të sigurt të dashurisë së Perëndisë. Kjo simbolikë e fuqishme gërshetohet në rrëfimet e atyre që shkojnë në male për të marrë zbulesë dhe në përshkrimin e Isaia për “shtëpi[në] e Zotit [që] do të vendoset në majën e maleve”. Shtëpia e Zotit është shtëpia e besëlidhjeve tona më të çmuara dhe një vend ku të gjithë ne të drejtohem dhe të zhytemi thellë

evidence of our Father's love for us. I have also enjoyed the comfort that comes to my soul when I wrap myself more tightly in my baptismal covenant and find someone who is mourning a loss or grieving a disappointment and I try to help them hold and process their feelings. Are these ways that we can become more immersed in the precious covenantal love here?

So if God's love does not leave us, why don't we always feel it? Just to manage your expectations: I don't know. But being loved is definitely not the same as feeling loved, and I have a few thoughts that might help you as you pursue your answers to that question.

Perhaps you are wrestling with grief, depression, betrayal, loneliness, disappointment, or other powerful intrusion into your ability to feel God's love for you. If so, these things can dull or suspend our ability to feel as we might otherwise feel. For a season at least, perhaps you will not be able to feel His love, and knowledge will have to suffice. But I wonder if you could experiment—patiently—with different ways of expressing and receiving divine love. Can you take a step back from whatever is in front of you and maybe another step and another, until you see a wider landscape, wider and wider still if necessary, until you are literally “thinking celestial” because you are looking at the stars and remembering worlds without number and through them their Creator?

Birdsong, feeling the sun or a breeze or rain on my skin, and times when nature puts my senses in awe of God—each has had a part in providing me with heavenly connection. Perhaps the comfort of faithful friends will help. Maybe music? Or serving? Have you kept a record or journal of times when your connection with God was clearer to you? Perhaps you could invite those you trust to share their sources of divine connection with you as you search for relief and understanding.

I wonder, if Jesus were to choose a place where you and He could meet, a private place where you would be able to have a singular focus on Him, might He choose your unique place

ne provën e dashurisë së Atit tonë për ne. Kam shijuar gjithashtu ngushëllimin që më vjen në shpirt kur kapem fort në besëlidhjen time të pagëzimit dhe gjej dikë që po vuan nga një humbje ose pikëllim prej një zhgënjimi dhe përpiqem ta ndihmoj atë t'i përmbajë dhe t'i shqyrtojë ndjenjat e veta. A janë këto mënyra se si mund të zhytemi më shumë në hesedë-indashurinë e çmuar besëlidhëse?

Pra, nëse dashuria e Perëndisë nuk na braktis, pse nuk e ndiejmë gjithmonë atë? Për t'i mbajtur nën kontroll pritshmëritë tuaja, ju them që nuk e di. Portë të duanpa dyshim nuk është njësoj sita ndieshse të duan dhe kam disa mendime që mund t'ju ndihmojnë teksa kërkon përgjigjet tuaja për atë pyetje.

Ndoshta po luftoni me pikëllimin, depresionin, tradhtinë, vetminë, zhgënjimin ose ndërhyrje të tjera të fuqishme në aftësinë tuaj për ta ndier dashurinë e Perëndisë për ju. Nëse është kështu, këto gjëra mund ta mpijnë ose pengojnë aftësinë tonë për t'u ndier siç mund të ndiheshim po të ishte ndryshe. Të paktën për një periudhë, ndoshta nuk do të jeni në gjendje ta ndien dashurinë e Tij dhe njohuria do të duhet të mjaftojë. Por pyes veten nëse mund të eksperimentoni, plot durim, me mënyrat e ndryshme për ta shprehur dhe marrë dashurinë hyjnore. A mund të bëni një hap prapa nga çfarëdo gjëje që keni përpara dhe ndoshta edhe një hap tjetër, edhe një tjetër, derisa të shihni një peizazh më të gjerë, gjithnjë duke e zgjeruar peizazhin më tej nëse është e nevojshme, aq sa të jeni mirëfilli duke “menduar çelëstialisht”, ngaqë po shihni yjet dhe po kujtoni botët pa numër dhe nëpërmjet atyre, Krijuesin e tyre?

Kënga e zogjve, të ndierit e diellit ose të një flladi apo të shiut në lëkurën time dhe ato raste kur natyra bën që shqisat e mia të mahniten nga Perëndia – secila nga këto ka pasur një rol në lidhjen time me qiellin. Ndoshta do t'ju ndihmojë ngushëllimi i miqve besnikë. Mbase muzika? Apo shërbimi? A keni mbajtur shënime apo ditar të rasteve kur lidhja juaj me Perëndinë ka qenë më e qartë për ju? Ndoshta mund t'i ftoni ata të cilëve u mirëbesoni, që t'ju tregojnë burimet e tyre të lidhjes hyjnore ndërsa kërkon lehtësim dhe kuptueshmëri.

Pyes veten, nëse Jezusi do të zgjidhte një vend ku ju dhe Ai mund të takoheshit, një vend në privatësi ku do të ishit në gjendje të kishit në fokus vetëm Atë, a mund ta zgjidhte Ai vendin

of personal suffering, the place of your deepest need, where no one else can go? Somewhere you feel so lonely that you must truly be all alone but you aren't quite, a place to which perhaps only He has travelled but actually has already prepared to meet you there when you arrive? If you are waiting for Him to come, might He already be there and within reach?

If you do feel filled with love in this season of your life, please try and hold on to it as effectively as a sieve holds water. Splash it everywhere you go. One of the miracles of the divine economy is that when we try to share Jesus's love, we find ourselves being filled up in a variation of the principle that "whosoever will lose his life for my sake shall find it."

Being filled with God's love shields us in life's storms but also makes the happy moments happier—our joyful days, when there is sunshine in the sky, are made even brighter by the sunshine in our souls.

Let's become "rooted and grounded" in our Jesus and in His love. Let's look for and treasure experiences of feeling His love and power in our lives. The joy of the gospel is available to all: not just the happy, not just the downcast. Joy is our purpose, not the gift of our circumstances. We have every good reason to "rejoice and be filled with love towards God and all men." Let's get full. In the name of Jesus Christ, amen.

tuaj unik të vuajtjes vetjake, vendin e nevojës suaj më të thellë, ku askush tjetër nuk mund të shkojë? Diku ku ndiheni aq i vetmuar, saqë duket se jeni vërtet krejt vetëm, por në të vërtetë nuk jeni, një vend të cilin ndoshta vetëm Ai e ka përshkuar, por që në të vërtetë e ka përgatitur tashmë për t'ju takuar atje kur të mbërrini? Nëse jeni duke pritur që Ai të vijë, a mund të jetë vallë Ai atje tashmë dhe aq afër sa ta arrini?

Nëse ndiheni të mbushur me dashuri në këtë periudhë të jetës suaj, ju lutemi, përpiquni ta mbani fort atë me aq efektshmëri sa ç'mban ujin një kullësë. Spërkateni kudo që të shkoni. Një nga mrekullitë e ekonomisë hyjnore është se kur përpiqemi ta shpërndajmë dashurinë e Jezusit, e gjejmë veten duke u mbushur si te parimi: "Ai që do ta humbasë jetën e vet për hirin tim, do ta gjejë atë".

Të qenit i mbushur me dashurinë e Perëndisë na mbron në stuhitë e jetës, por gjithashtu i bën çastet e lumtura edhe më të lumtura – ditët tona të gëzuara, kur ka diell në qiell, ndriçohen edhe më shumë nga rrezet e diellit në shpirtin tonë.

Le të bëhemi "të rrënjësuar dhe të themeluar" në Jezusin tonë dhe në dashurinë e Tij! Le t'i kërkojmë dhe t'i ruajmë si thesar përvojat e të ndierit të dashurisë dhe fuqisë së Tij në jetën tonë! Gëzimi i ungjillit është në dispozicion të të gjithëve: jo vetëm për të lumturit, jo vetëm për të dëshpëruarit. Gëzimi është qëllimi ynë, jo dhurata e rrethanave tona. Kemi çdo arsye të mirë për t'u "gëz[uar] dhe ... mbush[ur] me dashuri ndaj Perëndisë dhe ndaj gjithë njerëzve". Le të mbushemi me atë dashuri! Në emrin e Jezu Krishtit, amen.